

VENDIM
Nr. 159, datë 19.2.2020

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR
AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE, PËR
VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për vitin 2020, për shumën 384 760 000 (treqind e tetëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Pasqyra nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2020

Të ardhura	Në mijë lekë	Shpenzime	Në mijë lekë
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	164,000	Shpenzime për paga	117,711
Të ardhura nga pagesa për caktimin e përdorimin e frekuencave	132,000	Shpenzime për sigurimet shoqërore e shëndetësore	14,989
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26,000	Shpenzime për materiale	8,546
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	20,160	Shpenzime për shërbime	154,354
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar	8,500	Shpenzime për investime	89,160
Të ardhura nga pagesa për domain	9,400		
Të ardhura nga pagesa të tjera	700		
Të ardhura nga agjenti tatimor	24,000		
Totali i të ardhurave	384,760	Totali i shpenzimeve	384,760

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

